



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:240477

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06050054

**P.nr.409/2023**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.M...nga fshati S... Komuna e V..., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.1380/2023 të datës 05.10.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 14.08.2024, mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr. 1380/2023 të datës 05.10.2023, ndaj të pandehurit Sh.M..., nga babai B..., e ëma K..., i lindur më datë ..., nga fshati S.. Komuna e V..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal 1..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë 29.05.2023, rreth orës 14:12 minuta, në territorin e fshatit S., Komuna e V..., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në pyllin e pronës shtetërore, në vendin e quajtur „Rrezja”, i pandehuri me qëllim vjedhje, me sharrë motorike, ka prerë 23 copë dru të llojit „shkozë”, me diametër në cung 16-18 cm, me lartësi të drurit 17.5 cm, me gjatësi 12 m, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 3.50 m<sup>3</sup>, të cilat i ka bartur me traktor të markës „Rakovicë”, dhe në këtë mënyrë, të dëmtuarës APK-së, zyra në Viti, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 472 euro;

- me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s, si dhe nenit 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

### E G J Y K O N

I. Të pandehurit Sh.M...për veprën penale v Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

**II.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

**III.** E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridik civil.

**IV.** Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 05.10.2023 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr. PP.II.nr. 1380/2023 kundër të pandehurit Sh.M...nga fshati S.. Komuna e V..., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-s (dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë për të pandehurin me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-s.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë:

fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit me nr. 69/2023 i datës 01.08.2023, raporti i vlerësimit të dëmit nga komisioni i datës 01.08.2023, deklaratën e të pandehurit Sh.M...të dhënë më datë 22.09.2023, si dhe shkresat tjera në lëndë.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se këto të dhëna nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.409/2023, me datë 14.08.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale,**  
Vlora Selmani-Rahimi

**Gjyqtari i vetëm gjyqës,**  
Behar Ymeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqet kundërshtim në afat prej 8 ditëve.